Mbështesim zhvillimin e kompetencave transkulturore për profesionistët e shëndetit në Ballkanin perëndimor.

Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans, TCCWB



Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Albania

Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

Studim rasti klinik-1
Kujdesi infermieror për minoritetet në Gjirokastër



- Vendndodhja: Spitali Rajonal Gjirokastër, Urgjenca
- Pacienti: Znj. Kosta, 55 vjeç, nga një fshat i minoritetit grek në Gjirokastër. Ajo vuan nga diabet i pakontrolluar i tipit 2 (me zhvillim të ulçerës në këmbë), HTA dhe trombozë të venave popliteale në pulpën e majtë. Paraqitet me dhimbje gjoksi dhe vështirësi në frymëmarrje.
  Ajo flet kryesisht greqisht, ka kufizime në shqip dhe di pak shkrim-lexim në shqip.
  Djali i saj, Marko (30), u jep përparësi ilaçeve tradicionale dhe nuk ka besim te spitalet shqiptare. Znj. Kosta duket e shqetësuar se mos gjykohet dhe ia lë djalit vendimet.
- Infermieri duhet të koordinojë monitorimin e parametrave vitale, kontrollin e glicemisë dhe referimin e mundshëm për kujdes të specializuar, duke adresuar njëkohësisht barrierat gjuhësore, të besimit dhe të kulturës.

Kujdesi infermieror për minoritetet në Gjirokastër
Cilat janë sfidat kulturore në këtë rast?



- Komunikimi: Jemi pa përkthyes; mund të ketë keqkuptime.
- Besime dhe praktika: Pacientja ja ka lënë vendimmarrjen djalit.
- Besimi te sistemi shëndetësor: Djali i saj nuk ka besim te shërbimi shëndetësor shqiptar. Pacientja është konfuze.
- Konteksti social: Kultura e fshatit ku jetojnë, jetesa e kufizuar brenda fshatit të tyre dhe mungesa e integrimit me popullsinë shqiptare.

Kujdesi infermieror për minoritetet në Gjirokastër

Ndërhyrjet infermierore:

- Menaxhim i komunikimit: përdor pyetje të thjeshta, google translate ose një koleg që flet mirë greqisht
- Respektim i vlerave: respekto preferencat e pacientit
- Edukim i përshtatur: shpjegimi i gjëndjes, terapisë dhe rreziqeve të mundshme në një mënyrë të përshtatshme për pacienten.
- Dokumentim: Regjistro preferencat dhe nevojat e pacientit në kartelë